

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I
Z Y R T A R

vëllimi 27 numër 3 gusht 2025

Data e botimit: 21.8.2025

P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.28, datë 4.6.2025 "Për miratimin e një ndryshimi në statutin e Bankës së Shqipërisë" 5
2. Vendim i Zëvendësgubernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.2776, datë 16.6.2025 "Për shfuqizimin e licences së subjektit "NOA" sh.a. si institucion pagese" 6
3. Vendim i Gubernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.3015, datë 30.6.2025 "Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit" 8
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.30, datë 2.7.2025 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 9
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.31, datë 2.7.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"" 11
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.32, datë 2.7.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave"" 14
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.33, datë 2.7.2025 "Për një ndryshim në rregulloren "Për mbikëqyrjen e konsoliduar"" 16
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.35, datë 2.7.2025 "Për rishtypjen e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor, prerja 100 Lekë" 18
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.37, datë 6.8.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 19
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.38, datë 6.8.2025 "Për dhënien e miratimit paraprak për licencimin e degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania"" 21
11. Vendim i Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.5988, datë 8.8.2025 "Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të shoqërisë së kursim-kreditit "Tirana Invest Kredit 2000" me shoqërinë e kursim-kreditit "Fushas Mumajes"" 23
12. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 1, mars 2025 25
13. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 2, maj 2025 25



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 28, datë 4.6.2025

**PËR
MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË STATUTIN E BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në bazë të nenit 43, shkronjat "f" dhe "h" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Burimeve Njerëzore, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në Statutin e Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 90, datë 2.12.2015 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në nenin 15, pika 3, togfjalëshi "vetëm një", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në 3 (tre)".

2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
ZËVENDËSGUVERNATORI I DYTË

Nr. 2776 prot.

Tiranë, më 16.6.2025

VENDIM
Nr. 2776, datë 16.6.2025

PËR
SHFUQIZIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT "NOA" SH.A. SI INSTITUCION
PAGESE

Pasi u njoha me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, përcjellë me shkresën nr. 4368, datë 11.6.2025 me objekt "Shfuqizimi i licencës së subjektit NOA si institucion pagese", nga shqyrtimi i relacionit si dhe analizës së bërë për propozimin, si dhe duke vlerësuar shkaqet e përmendura,

VËREJ:

Subjekti "NOA" sh.a. është licencuar nga Banka e Shqipërisë me licencën nr. 09/2, datë 16.2.2024 për të ushtruar veprimtarinë si institucion pagese.

Me anë të shkresës nr. 52340 datë 14.4.2025, "NOA" ka njoftuar se pasi ka marrë licencën Nr. 9/2, datë 16.2.2024 për të vepruar si institucion pagese, nuk e ka ushtruar këtë veprimtari, për shkaqe teknike që lidhen me ndërtimin e infrastrukturës së duhur mbështetëse. Këto shkaqe do të vijojnë të ekzistojnë së paku deri në nëntor 2025 (sipas parashikimit të subjektit).

Veprimtaria si agjent për shërbimet e pagesave që "NOA" sh.a. ka kryer gjatë këtij viti nuk e justifikon mbajtjen e licencës si institucion pagese.

Departamenti i Mbikëqyrjes, në përputhje me parashikimet e nenit 15, pika 1/a e ligjit nr.55/2020 "Për shërbimet e pagesave", cit: Banka e Shqipërisë shfuqizon licencën e dhënë kur institucioni i pagesave:

a) nuk ka filluar veprimtarinë brenda 12 muajve nga data e marrjes së licencës apo ka ndërprerë veprimtarinë për më

shumë se 6 muaj, përveç rasteve kur një ndërprerje e tillë është vendosur nga Banka e Shqipërisë”;

vlerësoi shfuqizimin e licencës së subjektit “NOA sh.a. si institucion pagese, pasi subjekti NOA sh.a. nuk ka filluar ushtrimin e veprimtarisë brenda një periudhe 12-mujore nga data e marrjes së licencës.

Në vijim, në zbatim të procedurës së njoftimit dhe dëgjimit të palëve të parashikuar në nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative, me anë të shkresës Nr. 3700 Prot., datë 12.05.2025, subjekti “NOA” sh.a. është njoftuar për masën e propozuar dhe për periudhën 5-ditore brenda të cilës duhet të shprehej me shkrim mbi këtë masë.

Me përfundimin e afatit të parashikuar, subjekti nuk ka reaguar ndaj njoftimit të mësipërm.

Në përfundim duke vlerësuar se konstatimet e Departamentit të Mbikëqyrjes përbëjnë shkëlqje të parashikuara në nenin 15, pika 1 shkronja “a” të ligjit nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, dhe neneve 98, 99 dhe 100 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të shtojcës nr. 3, pika 17 të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.36, datë 26.5.2010, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Shfuqizimin e licencës nr. 9/2 datë 16.2.2024 të subjektit NOA sh.a. si institucion pagese.
2. Subjekti NOA sh.a ka të drejtë të paraqesë ankim pranë Guvernatorit brenda 30 ditëve nga data kur ka marrë njoftim ose nga data e publikimit të këtij akti.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSGUVERNATORI I DYTË

NATASHA AHMETAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 3015

Tiranë, më 30.6.2025

VENDIM
Nr. 3015, datë 30.6.2025

PËR
CAKTIMIN E SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT

Në bazë dhe për zbatim të neneve 11, 12 dhe nenit 16, pika 1, shkronja "ç", të rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit" miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bazuar në propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar,

VENDOSA:

1. Norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë mbetet në 0.50 (zero pikë pesëdhjetë) për qind.
2. Bankat duhet të raportojnë shkallën e përmbushjes së shtesës kundërciklike të kapitalit sipas paragrafit 1, duke filluar me datën 30 qershor 2026.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATOR

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 30, datë 2.7.2025

PËR
ULJEN E NORMËS SË INTERESIT TË MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË
ANASJELLA TË RIBLERJES DHE TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS
NJËDITORE DHE TË KREDISË NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të ulë, në nivelin 2.50 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të ulë, në nivelin 1.50 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të ulë, në nivelin 3.50 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi më 9 korrik 2025.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 31, datë 2.7.2025

**PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
“PËR RAPORTIN E MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 58, shkronjat “a”, “b”, “c”, dhe të nenit 60, pika 2, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, e ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:
 - a) Pas nenit 19/1, shtohet neni 19/2 me përmbajtjen e mëposhtme:

**“Neni 19/2
Ekspozimet ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në
infrastruktura strategjike transporti**

1. Bankat identifikojnë në mënyrë të veçuar nga klasa e ekspozimeve ndaj shoqërive tregtare, ekspozimet ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në infrastruktura strategjike transporti, siç parashikohen në pikën 2 të këtij neni, të cilat plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) ekspozimi është ndaj një shoqërie tregtare, për të financuar ose vënë në funksionim projekte në infrastruktura strategjike transporti, që lidhet me projekte në një nga fushat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni;
 - b) financimi ka një afat maturimi deri në 10 vjet;
 - c) kontrata e kredisë për ekspozimin në fjalë, i siguron bankës një nivel të lartë kontrolli mbi aktivet e projektit dhe të ardhurat që gjenerohen prej tij;
 - d) burimi i shlyerjes së kredisë (detyrimit) përbëhet minimalisht në masën dy të tretat nga të ardhurat që gjenerohen nga projekti i financuar;
 - e) huamarrësi mund të përmbushë detyrimet e tij financiare, edhe në kushte të theksuara stresi që lidhen me rrezikun e projektit të financuar;
 - f) përfitues fundor i projektit të financuar është qeveria shqiptare.
2. Për qëllime të këtij neni, projekte në infrastruktura strategjike të transportit do të konsiderohen financimet e projekteve në formën e ndërtimit të një infrastrukture të re ose të një infrastrukture ekzistuese, në fushat e transportit rrugor dhe të infrastrukturës portuale dhe aeroportuale, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore dhe ku shoqëria tregtare ka një kontratë/marrëveshje me institucionin shtetëror përkatës.
 3. Për qëllime të këtij neni, bankat ponderojnë ekspozimet ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në infrastruktura strategjike transporti, me peshën e rrezikut 50%, vetëm nëse plotësohen kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.
 4. Parashikimet e këtij neni do të zbatohen për të gjitha ekspozimet ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në infrastruktura strategjike transporti, që do të krijohen deri në 31 dhjetor 2026 dhe do të jenë të zbatueshme deri në afatin e miratuar të financimit, që në çdo rast ky i fundit nuk tejkalon 10 vjet.”.
2. Për të gjitha bankat që do të përfitojnë nga ndryshimi rregullativ i mësipërm, të lejohet shpërndarja e fitimit të mbartur nga periudhat e mëparshme, apo e fitimit të realizuar në vitin 2025 dhe 2026, deri në 50%.
 3. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
 5. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare

të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 32, datë 2.7.2025

PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
“PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË
BANKAVE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 57, pika 2, nenit 58, shkronjat “b” dhe “c”, neneve 60, 62, 63, 64, 65 dhe 131 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 10, datë 26.2.2014, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në nenin 8, pika 2, pas shkronjës “p”, shtohet shkronja “q” me përmbajtjen e mëposhtme:

“q) ekspozimet, me jo më shumë se 50% të vlerës së tyre, ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në infrastruktura strategjike transporti, siç parashikohet në nenin 19/2 të rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit.”;
 - b) Në nenin 13, paragrafi ekzistues bëhet pika 1, si dhe shtohet pika 2 me përmbajtjen e mëposhtme:

"2. Parashikimet e shkronjës "q" të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje do të zbatohen për të gjitha ekspozimet ndaj shoqërive tregtare që financojnë projekte në infrastruktura strategjike transporti që do të krijohen deri në 31 dhjetor 2026 dhe do të jenë të zbatueshme deri në afatin e miratuar të financimit, që në çdo rast ky i fundit nuk tejkalon 10 vjet.";

- c) Në Aneksin 2, në Udhëzuesin shpjegues për plotësimin e formularit nr. 1, përshkrimi i kolonës nr. 27, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

Shuma e përjashtimeve në përputhje me shkronjat "a", "b", pjesërisht shkronjën "d", pjesërisht shkronjën "e" dhe shkronjat "h", "i", "j", "l", "m", "n", "p" dhe "q", të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje."

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 33, datë 2.7.2025

PËR
NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN "PËR MBIKËQYRJEN E
KONSOLIDUAR"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të Nënkreut II të Kreut VI të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për mbikëqyrjen e konsoliduar", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 1.2.2017, e ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:
 - a) Në Aneksin 4, në Udhëzuesin shpjegues për plotësimin e formularit nr. 1, përshkrimi i kolonës nr. 27, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Shuma e përjashtimeve në përputhje me shkronjat "a", "b", pjesërisht shkronjën "d", pjesërisht shkronjën "e" dhe shkronjat "h", "i", "j", "l", "m", "n", "p" dhe "q", të pikës 2 të nenit 8 të rregullores "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha"."
2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr. 35, datë 2.7.2025

**PËR
RISHTYPJEN E MONEDHËS METALIKE SHQIPTARE ME KURS LIGJOR,
PRERJA 100 LEKË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 33, pikat 2 dhe 3, nenit 36, nenit 39, pika 2, dhe nenit 43, shkronjat "c" dhe "d" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 16 të rregullores "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor", miratuar me vendimin nr. 133, datë 7.12.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rishtypjen e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor prerja 100 Lekë, në përputhje me përcaktimet e Aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Viti i shtypjes, i shfaqur në trupin e monedhave metalike, të jetë viti 2026.
3. Ngarkohet Departamenti i Emisionit me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, me përjashtim të Aneksit 1, që përmban informacion të klasifikuar jopublik "sekret bankar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

KRYETARI

ELVIS ÇIBUKU

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 37, datë 6.8.2025

PËR
MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË
MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE
TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË
NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbiqëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.50 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.50 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.50 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM
Nr. 38, datë 6.8.2025

**PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK
PËR LICENCIMIN E DEGËS SË BANKËS SË HUAJ NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË "DEGA E BANKËS TURKIYE CUMHURIYETI ZIRAAT BANKASI
A.S., ALBANIA"**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e" të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të pikave 1 dhe 2 të nenit 19 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; të pikës 1 të Shtojcës nr. 1 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar; dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për licencimin e degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania".
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

ELVIS ÇIBUKU

KRYETARI

GENT SEJKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES

Nr. 5988 Prot.

Tiranë, më 8.8.2025

VENDIM
Nr. 5988, datë 8.8.2025

PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË
SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT "TIRANA INVEST KREDIT 2000" ME
SHOQËRINË E KURSIM-KREDITIT "FUSHAS MUMAJES"¹

Në bazë dhe për zbatim të nenit 50 dhe 54 të ligjit nr. 52/2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre"; të nenit 25 dhe nenit 29 të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre", miratuar me vendimin nr. 104, datë 5.10.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; dhe të pikave 7 dhe 8, shtojca nr. 4, nënndarja IV, të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar;

VENDOSA:

1. Të japë miratimin paraprak për bashkimin me përthithje të shoqërisë së kursim-kreditit "TIRANA INVEST KREDIT 2000", Tiranë (shoqëria përthithëse) me shoqërinë e kursim-kreditit "Fushas Mumajes", Tiranë (shoqëria e përthithur).
2. Të revokojë licencën nr. 66, datë 23.9.2002, të shoqërisë së kursim-kreditit "Fushas Mumajes", Tiranë (shoqëria e përthithur). Ky revokim hyn në fuqi pas çregjistrimit nga Qendra Kombëtare e Biznesit të shoqërisë së kursim-kreditit "Fushas Mumajes", Tiranë

¹ Shoqëria e Kursim-Kreditit "Fushas Mumajes" ka ndryshuar në QKB, emrin në "Tirana Investing Kredit" (dt. 4.4.2017) dhe e ka kthyer përsëri emrin në shoqëria e kursim-kreditit "Fushas Mumajes" (dt. 2.11.2022).

(shoqëria e përrhithur), sipas nenit 50 të ligjit nr. 52/2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre". Shoqëria e kursim-kreditit "TIRANA INVEST KREDIT 2000", Tiranë (shoqëria përrhithëse) paraqet në Bankën e Shqipërisë një kopje të ekstraktit të QKB-së, ku konfirmohet çregjistrimi i shoqërisë së kursim-kreditit "Fushas Mumajes", Tiranë (shoqëria e përrhithur).

3. Shoqëria e kursim-kreditit "TIRANA INVEST KREDIT 2000", Tiranë (shoqëria përrhithëse), duhet të dorëzojë në Bankën e Shqipërisë, licencën e revokuar të shoqërisë së kursim-kreditit "Fushas Mumajes", Tiranë (shoqëria e përrhithur), pas hyrjes në fuqi të revokimit.
4. Shoqëria e kursim-kreditit "TIRANA INVEST KREDIT 2000", Tiranë (shoqëria përrhithëse), do të ushtrojë vetëm veprimtaritë për të cilat është licencuar.
5. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
7. Ky vendim i njoftohet Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR

DENIZ DERALLA

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 1, MARS 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 3, datë 15.1.2025 për "Miratimin e Programit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri dhe dokumentacionit shoqërues"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 9, datë 5.2.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 10, datë 5.2.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare""
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 11, datë 5.2.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare""
5. Vendim i Zëvendësgubernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 1072, datë 4.3.2025 për "Miratimin e politikës së administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.14, datë 5.3.2025 "Për kryerjen e pagesës së rritjes së kuotës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 2, MAJ 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.16, datë 26.3.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.17, datë 26.3.2025 "Për miratimin e "Pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2024""
3. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.1456, datë 28.3.2025 "Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.20, datë 2.4.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Mbikëqyrjes""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.22, datë 2.4.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit""
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.24, datë 7.5.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.25, datë 7.5.2025 "Për vendosjen e kufijve të sipërm për treguesit "Raporti i kredisë ndaj vlerës" dhe "Raporti i shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave" për kreditë që japin bankat për pasuri të paluajtshme rezidenciale"

8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.26, datë 7.5.2025 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor””
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.27, datë 7.5.2025 “Për rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, me prerje 2000 Lekë”

